

Titulli: Kozacioğlu Tur

Titulli: Kozacioğlu Tur

Ankesa Nr

Titulli: *Turqi* Kozacioğlu Tur

Titulli: Kozacioğlu Tur

Ankesa Nr

Shteti Turqia

Pergjegjes

Data e vendimit 19 shkurt

Organi vendimmarres

Thelbi i vendimit

Nenent e KEDNJ: Neni 6
Neni 1P1
Neni 41

Link ne HUDOC

Fjalekyce per kerkim ne HUDOC

Jurisprudenca e cituar

Buletini I

Dhoma e madhe (Grand Chamber)

Ankuesi pretendon shkelje te te drejtes se tij per te gezuar pronen. Gjithashtu ai pretendoi se procesi i zhvilluar nga gjykata vendase ishte i parregullt pasi gjykata nuk kishin caktuar nje ekspert te kualifikuar ne historine e artit ne menyre qe te vleresonte vleren kulturore dhe historike te godines objekt gjykimi. Gjykata vendosi se mungesa e marrjes parasysh te karakteristikeve te nje prone te shproneluar ne perlogaritjen e kompensimit te saj perben shkelje te te drejtes se prones te garantuar nga Konventa.

Analiza e nenit 6 ne kuadrin e nenit 1P1

Konkluzioni

Shkelje e nenit 1P1

Akordim demi material

<http://cmiskp.echr.coe.int/tkp197/view.asp?action=html&documentId=847442&portal=hbkmsource=externalbydocnumber&table=F69A27FD8FB86142BF01C1166DEA398649>

"DEPRIVATION OF PROPERTY" "EXHAUSTION OF DOMESTIC REMEDIES" "JUST SATISFACTION{ART 41}" "MARGIN OF APPRECIATION" "PECUNIARY DAMAGE" "PROPORTIONALITY "PUBLIC INTEREST{P11}" "SIX MONTH PERIOD"

Beyeler v. Italy [GC], no. 33202/96, §§ 106, 107 and 112, ECHR 2001 ; Beyeler v. Italy (just satisfaction) [GC], no. 33202/96, § 27, 28 May 2002 ; Broniowski v. Poland [GC], no. 31443/96, § 182, ECHR 2004V ; Brumarescu v. Romania (just satisfaction) [GC], no. 28342/95, § 20, ECHR 2000I ; Debelianovi v. Bulgaria, no. 61951/00, § 54, 29 March 2007 ; Hamer v. Belgium, no. 21861/03, § 79, ECHR

KOZACIOĞLU k. TURQISE

Faktet dhe pretendimet

Ne prill 2000, nje godine prone e ankuesit, u shpronesua nga Ministria e Kultures me motivin se ishte klasifikuar si nje "prone monument kulture" ne kembim te kompensimit ne vleren rreth EUR 65326. Ne tetor 2000, ankuesi paraqiti nje kerkese padi ne gjykatën turke kompetente duke kerkuar rritje te vleres se kompensimit te prones se tij, ne masen e caktuar prej nje grupi ekspertesh, duke marre parasysh vleren e saj historike. Ankuesi pretendoi se godina ishte klasifikuar nga Keshilli i Evropes si nje trashegimi kulturore dhe natyrore ndaj kompensimit te saj te parashikuar me pare duhet ti shtohet vlere rreth EUR 1 728 750.

Ne 2001, dy grupe te ndryshme ekspertesh te emeruar nga gjykata vleresuan se duke pasur parasysh natyren dhe vecantine e prones, vlere e saj duhet te rritej me 100%. Ne 15 qershor 2001 gjykata vendase pranoi pjeserisht pretendimet e ankuesit dhe urdheroi pagesen e nje kompensimi shtese ne vleren EUR 139 728 mbi ate te kompensuar tashme. Por ne 19 nentor 2001 Gjykata e Larte prishi vendimin me arsyetimin se ne baze te nenit 15 (d) te ligjit mbi monumentet trashegimi kulturore dhe natyrore (ligji No. 2863), per percaktimin e vleres se godinave objekt shpronesimi nuk duhet te merren parasysh karakteristikat e tyre arkitekturale, kulturore apo vecantia e tyre.

Ne maj 2002 gjykata vendase ne nje vendim te formes se prere i akorduan ankuesit nje kompensim rreth EUR 45 980 mbi ate te akorduar fillimisht.

Me date 11 nentor 2002 ankuesi paraqiti nje kerkese ne Gjykatën Evropiane te te Drejtave te Njeriut

(GJEDNJ) ne Strasburg. Pas vdekjes se Z Ibrahim Kozacioğlu, ne vitin 2005 trashegimtaret e tij vazhduan procesin ne GJEDNJ.

Ne vendimin e saj date 31 korrik 2007 GJEDNJ, me nje trup gjykues te perbere nga 7 gjyqtare me 4 vota mbi 3 vota, vendosi shkelje te drejtes se prones te garantuar nga Neni 1 i Protokollit nr 1 te Konventes. Gjykata vleresoi se vlere historike e godines se shpronesuar nuk ishte marre parasysh nga autoritetet si gjate vleresimit te kompensimit te saj ne procesin fillestar te shpronesimit ashtu edhe nga gjykatat ne perlllogaritjen e re te ketij kompensimi. Per kete arsye, mosmarrja parasysh nga autoritetet i ketij kriteri ne perlllogaritjen e vleres se kompensimit per shpronesimin e prones, cenoi te drejten e ankuesit mbi pronen objekt shpronesimi. Gjykata gjithashtu konstatoi se shkelja ne vetevehte perben prova per demin material te shkaktuar, ndaj i akordoi ankuesit 75 000 euro dhe 1 000 euro per shpenzimet.

Me 31 tetor 2007, ne baze te nenit 43 te Konventes Evropiane te Drejtave te Njeriut (KEDNJ), Qeveria Turke kerkoi qe ceshtja te apelohej ne Dhomen e Madhe te perbere nga 17 gjyqtare. Kerkesa u pranua nga paneli seleksionues i Dhomes se Madhe te GJEDNJ dhe nje seance degjimore u mbajt ne Strasbourg me date 2 korrik 2008.

Komente mbi Vendimin e Dhomes se Madhe

Dhoma e Madhe konfirmoi vendimin e Dhomes me 7 gjyqtare se ne rastin konkret kishte pasur nje shkelje te drejtes se prones se ankuesit ne kuptimin e nenit 1 te Protokollit Nr 1 te Konventes Evropiane te Drejtave te Njeriut (KEDNJ).

Dhoma e Madhe analizoi me gjeresisht nderhyrjen e autoriteteve ne kuadrin e shpronesimeve per interes publik si dhe raportin e drejte qe duhet te krijohet mes interesave te individeve dhe interesit publik.

Konkretisht Dhoma e Madhe konstatoi se nderhyrja e autoriteteve ne te drejten e prones se ankuesit kishte ardhur si rezultat i zbatimit te ligjit dhe se kjo nderhyrje kishte pasur qellim te ligjshem, i.e. mbrojtja e trashegimise kulturore te shtetit Turk.

Gjykata u mbeshtet ne praktiken e saj mbi shpronesimet ne te cilen ajo ka pranuar se nese shpronesimi per interes publik i nje prone private ploteson kushtet e ligjshmerise (baza ligjore dhe perndjekja e nje qellimi te ligjshem), mungesa e kompensimit te subjektit te shpronesuar me vleren e tregut per pronen e tij, nuk perben ne vetevehte shkelje te Konventes ne pergjithesi, apo te drejtes se prones ne vecanti, me kusht qe subjekti i shpronesuar te mos ngarkohet me nje barre jo proporcionale dhe te tepruar ne raport me interesin publik te perndjekur.

Ne rastin konkret procesi i vleresimit te kompensimit ne baze te drejtes se vendit bente te mundur konstatimin nese vlere e kompensimit kishte respektuar ose jo kushtin e vleresimit te drejte (*fair balance*), dhe nese ajo kishte vendur nje mase jo proporcionale mbi ankuesin.

Gjykata ne praktiken e saj te hershme kishte vendosur se marrja e prones pa kompensuar privatin ne nje vlere te arsyeshme te prones, normalisht perbente nje nderhyrje te paproporcionuar dhe si e tille nje shkelje te Konventes. Neni 1 i Protokollit nr 1 te KEDNJ nuk garanton te drejten e nje kompensimi te plote ne kuadrin e shpronesimit per interesa publike, prandaj ne disa raste legjitimimi objektivi i interesit publik mundet te kerkoje qe prona e shpronesuar te mund te kompensohet me nje vlere me te vogel se ajo e tregut te lire.

Gjykata konstaton se mbrojtja e trashegimise kulturore dhe historike nuk perben nje nga keto lloj objektivash. Ne rastin konkret ne vleresimin e vleres se kompensimit per t'iu akorduar ankuesit, autoritetet vendase nuk moren parasysh as vecantine e godines dhe as karakteristikat e saj historike dhe kulturore.

Gjykata pranoi faktin se vlere e tregut e godinave te vecanta (landmark buildings) mund te jete e veshtire per tu vleresuar. Megjithate ajo konstatoi se edhe pse ne kuadrin e legjislacionit Turk vlerat specifike te godinave te shpronesuara nuk merreshin parasysh per rritjen e vleres se kompensimit te tyre, gjyqesori ne praktike i merrete ato parasysh sidomos per c'vleresimin e vleres se godinave. Gjykata konstatoi se ky lloj sistemi vleresimesh ishte i padrejte pasi ai vendoste shtetin ne nje pozite favorizuese. Gjithashtu ajo vuri re se diskrecioni i marrjes parasysh te vlerave te vecanta historike apo arkitekturale ne vleresimin e pasurive te shpronesuara (landmark building) nuk ishte i parashikuar ne vende te tjera anetare te Keshillit te Evropes.

Per sa me siper ajo vendosi se mungesa e vleresimit ne nje nivel te pranushem te karakteristikave specifike te nje godine te shproneluar ne perlllogaritjen e vleres se kompensimit te saj perben nje nderhyrje jo proporcionale ne interesin e individeve e si e tille ne shkelje te Nenit 1 te Protokollit Nr 1 te KEDNJ. Duke pasur parasysh perfundimin e arritur gjate analizes se nenit 1 te Protokollit Nr 1 Gjykata vendosi se nuk ishte e nevojshme te analizonte pretendimet e ankuesit ne kuader te nenit 6 te Konventes.

JUSSILA k. FINLANDES

Titulli: *Kozacioğlu Tur*

Titulli: *Kozacioğlu Tur*

Ankesa Nr

Titulli: *Turri Kozacioğlu Tur*

Titulli: *Kozacioğlu Tur*

Ankesa Nr

Shteti *Turqia*

Pergjegjes

Data e vendimit *19 shkurt*

Organi vendimmarres

Thelbi i vendimit

Nenent e KEDNJ:

*Neni 6
Neni 1P1
Neni 41*

Link ne HUDOC

Fjalekyce per kerkim ne HUDOC

Jurisprudenca e cituar

Dhoma e madhe (Grand Chamber)

Ankuesi pretendon shkelje te te drejtes se tij per te gezuar pronen. Gjithashtu ai pretendoi se procesi i zhvilluar nga gjykata vendase ishte i parregullt pasi gjykata nuk kishin caktuar nje ekspert te kualifikuar ne historine e artit ne menyre qe te vleresonte vleren kulturore dhe historike te godines objekt gjykimi. Gjykata vendosi se mungesa e marrjes parasysh te karakteristikave te nje prone te shproneluar ne perlllogaritjen e kompensimit te saj perben shkelje te te drejtes se prones te garantuar nga Konventa.

Analiza e nenit 6 ne kuadrin e nenit

1P1

Shkelje e nenit 1P1

Akordim demi material

Konkluzioni

<http://cmiskp.echr.coe.int/tkp197/view.asp?action=html&documentId=847442&portal=hbk&source=externalbydocnumber&table=F69A27FD8FB86142BF01C1166DEA398649>

"DEPRIVATION OF PROPERTY" "EXHAUSTION OF DOMESTIC REMEDIES" "JUST SATISFACTION{ART 41}" "MARGIN OF APPRECIATION" "PECUNIARY DAMAGE" "PROPORTIONALITY" "PUBLIC INTEREST{P11}" "SIX MONTH PERIOD"
Beyeler v. Italy [GC], no. 33202/96, §§ 106, 107 and 112, ECHR 2001 ; Beyeler v. Italy (just satisfaction) [GC], no. 33202/96, § 27, 28 May 2002 ; Broniowski v. Poland [GC], no. 31443/96, § 182, ECHR 2004V ; Brumarescu v. Romania (just satisfaction) [GC], no. 28342/95, § 20, ECHR 2000I ; Debelianovi v. Bulgaria, no. 61951/00, § 54, 29 March 2007 ; Hamer v. Belgium, no. 21861/03, § 79, ECHR 2007 ; Iatridis v. Greece [GC], no. 31107/96, § 55, ECHR II ; Iatridis v. Greece (just satisfaction) [GC], no. 31107/96, § 32, ECHR 2000XI ; Ilhan v. Turkey [GC], no. 22277/93, § 59, ECHR 2000VII ; James and Others v. the United Kingdom, 21 February 1986, §§ 37, 46 and 54, Series A no. 98 ; Lithgow and Others v. the United Kingdom, 8 July 1986, § 171, Series A no. 102 ; Panamirhalanoulis and

Faktet dhe pretendimet

Ceshtja i perket nje ankimi te paraqitur nga nje shtetas Finlandez i lindur ne vitin 1949 dhe banues ne Tampere (Finlande). Ne 22 maj 1998, Zyra e Taksave ne Häme i kerkoi ankuesit te parashtroje vezhgimet e tij ne lidhje me disa shkelje te prezumuara ne deklarimin e Taksas se Vleres se Shtuar (TVSH) te bere prej tij per vitin fiskal 1994 dhe 1995. Ne 9 korrik 1998, Zyra e Taksave konstatoi se ankuesi ishte, midis te tjerave, i detyruar te paguante nje mbivlere takse qe arrinte ne 10% te vleres se TVSH. Mbivlera e shtuar e taksas ishte rreth 308.80 euro.

Ankuesi apeloj ne Gjykatën Administrative te Rrethit te Uusimaa (qe me vone u be Gjykata Administrative e Helsinkit). Ankuesi kerkoi nje seance degjimore dhe qe nje inspektor taksash dhe nje ekspert i caktuar prej tij te degjoheshin si deshmitare. Ne 1 shkurt 2000, Gjykata Administrative e Helsinkit mori nje vendim te ndermjetem duke ftuar palet te paraqisnin vezhgime me shkrim. Inspektoriati i taksave dergoi

deklaraten e tij ne Gjykatën Administrative ne 13 shkurt 2000. Me tej, deklarata iu dergua ankuesit per ti komentuar. Ne 25 prill 2000, ankuesi parashtroi vzhgimet e tij mbi deklaraten e inspektorit te taksave. Deklarata e ekspertit te zgjedhur prej tij iu parashtrua gjykates ne te njejten date.

Ne 13 qershor 2000, Gjykata vendosi se nje seance degjimore ishte e panevojshme, pasi te dyja palet kishin parashtruar me shkrim te gjithë informacionin e nevojshem. Gjithashtu ajo rrezoi kerkesen e ankuesit.

Ankesi paraqiti nje ankese ne GJEDNJ duke pretenduar se nuk kishte pasur nje proces te rregullt pasi gjykata vendosi pa nje seance degjimore, ne kundershkrim sipas tij te nenit 6 te Konventes.

Komente mbi vendimi e Dhomes se Madhe

Perpara se te analizonte ne themel pretendimin e ankuesit per shkelje te nenit 6 § 1 te Konventes, GJEDNJ vleresoi nese garancite e ketij neni ishin te zbatueshme ne procedurat per vleresimin e vleres se shtuar te taksa/tatimeve.

Ne fakt ajo konstatoi se edhe pse vlere e shtuar e taksës ishte pjese e procesit me karakter fiskal, qellimi i vendosjes se saj ishte i ndryshem nga ai i percaktimit te vleres se taksës/tatimit pasi ai kishte karakter denues dhe ndershkues. Ne keto kushte, Gjykata vendosi se percaktimi i vleres se shtuar te taksës/tatimit kishte natyre te ndershkimit penal ne kuptimin e nenit 6 te Konventes prandaj ne nje votim 13 me 4 vota vendosi zbatimin e garancive penale te nenit 6 te Konventes ne rastin konkret.

Per me teper Gjykata vuri ne dukje se qellimi i ankuesit ne kerkimin e nje seance degjimore ishte te kontrollonte besueshmerine dhe perpikmerine e raportit te inspektoriatit te taksave duke e kontestuar si dhe duke siguruar deshmi mbeshtetese nga eksperti i tij, meqenese, sipas pikeveshtrimit te tij, inspektori i taksave kishte keqinterpretuar kerkesat e legjislacionit perkates dhe kishte paraqitur nje situatë te pasakte te pozicionit te tij financiar. Si rrjedhim, arsyet qe ai paraqiti per kerkimin e nje degjimi, i perkisnin ne pjesen me te madhe te tyre analizes se vlefshmerise se vleresimit te mbivleres e cila si e tille dilte jashte qelimit te Artikullit 6, megjithese shtohet pyetja nese mbajtja e dokumentave financiare nga ana e aplikantit kishte qene aq e pamjaftueshme sa te arsyetonte nje mbivlere.

Gjykata Administrative, e cila mori masen e kerkimit te vezhgimeve me shkrim nga inspektori i taksave, dhe mbas nje deklarate te nje eksperti te zgjedhur nga ankuesi, vendosi se mbajtja e seances degjimore ishte e panevojshme ne rastin konkret pasi provat e paraqitura nga ankesi mjaftonin per gjykatën te vendoste.

Gjykata nuk dyshonte se dhenia e llogarise mbi situatën e taksapaguesit, si edhe dokumentet mbeshtetese, shpesh mund te ishin me efikase ne forme te shkruar sesa orale. Gjithashtu, Gjykata vuri ne dukje se ankuesit nuk iu ndalua mundesia e kerkeses se nje seance degjimore, megjithese i perkiste gjykatave te vendosin nese degjimi ishte i nevojshem.

Gjykata, duke pasur parasysh vleren e ulet te taksës se shtuar, arsyetimin e gjere te dhene nga Gjykata Administrative ne vendimin e saj per mos degjim te pales, si dhe faktin se ankuesi kishte pasur mjaftueshem mundesi per te prezantuar me shkrim pretendimet e tij ne kundervenie te tezes se autoritetit te taksave, vendosi se ne kushtet e vecanta te rastit konkret, procesi kishte qene i rregullt e si rrjedhoje nuk kishte pasur shkelje te nenit 6 § 1 te Konventes.

Titulli: Kozacioğlu Tur

Titulli: Kozacioğlu Tur

Ankesa Nr

Titulli: Kozacioğlu Tur

Titulli: Kozacioğlu Tur

Ankesa Nr

Shteti Turqia

Pergjegjes

Data e vendimit 19 shkurt

Organi vendimmarres

Thelbi i vendimit

Titulli: Kozacioğlu Tur
Ankesa Nr KEDNJ: Neni 6
Shteti Turqia Neni 1P1
Neni 41

Pergjegjes

Data e vendimit 19 shkurt

Organi vendimmarres

Thelbi i vendimit

Nenent e KEDNJ: Neni 6
Neni 1P1
Neni 41

Link ne HUDOC

VILHO ESKELINEN dhe te tjere k Finlandes

Dhoma e madhe (Grand Chamber)

Ankuesi pretendon shkelje te te drejtes se tij per te gezuar pronen. Gjithashtu ai pretendoi se procesi i zhvilluar nga gjykatat vendase ishte i parregullt pasi gjykatat nuk kishin caktuar nje ekspert te kualifikuar ne historine e artit ne menyre qe te vleresonte vleren kulturore dhe historike te godines objekt gjykimi. Gjykata vendosi se mungesa e marrjes parasysht te karakteristikave te nje prone te shpronesuar ne perlogaritjen e kompensimit te saj perben shkelje te te drejtes se prones te garantuar nga Konventa.

Analiza e nenit 6 ne kuadrin e nenit 1P1

Konkluzioni

Shkelje e nenit 1P1

Dhoma e madhe (Grand Chamber)

Ankuesi pretendon shkelje te te drejtes se tij per te gezuar pronen. Gjithashtu ai pretendoi se procesi i zhvilluar nga gjykatat vendase ishte i parregullt pasi gjykatat nuk kishin caktuar nje ekspert te kualifikuar ne historine e artit ne menyre qe te vleresonte vleren kulturore dhe historike te godines objekt gjykimi. Gjykata vendosi se mungesa e marrjes parasysht te karakteristikave te nje prone te shpronesuar ne perlogaritjen e kompensimit te saj perben shkelje te te drejtes se prones te garantuar nga Konventa.

Analiza e nenit 6 ne kuadrin e nenit 1P1

Konkluzioni

Shkelje e nenit 1P1

Akordim demi material

<http://cmiskp.echr.coe.int/tkp197/view.asp?action=html&documentId=847442&portal=hbkm&source=externalbydocnumber&table=F69A27FD8FB86142BF01C1166DEA398649>

"DEPRIVATION OF PROPERTY" "EXHAUSTION OF DOMESTIC REMEDIES" "JUST SATISFACTION{ART 41}" "MARGIN OF APPRECIATION" "PECUNIARY DAMAGE"

Faktet dhe pretendimet

Ankuesit ishin nenpunes civile, perfshire 5 punonjes policie. Ne vitin 1990 pas bashkimit te Distriktit, ne administraten e te cilit ata punonin, me nje Distrikt tjetër, ankuesit humben shtesa te rroges se tyre individuale te cilat zbatoheshin ne baze te nje kontrate kolektive te zbatueshme vetem ne distriktin e meparshem per punonjesit qe punonin ne zona te largeta.

Ankuesit pretenduan se komanda e policies se rrethit i kishte premtuar kompensim per humbjen e rritjes se rroges se tyre, por kjo nuk ndodhi kurre.

Ne 1991 Ministria e Finances rrezoi kerkesen per autorizim qe ti paguhej cdo ankuesi nje shtese rroge rreth EUR 84-118.

Ne vitin 1993 ankuesit prezantuan nje ankim ne organin me te larte administrativ (Juopio County

Administrative Board). Me 1997, pas 4 vjetesh, organi administrativ rrezoi kerkesat e tyre. Ankuesit kontestuan kete vendim ne Gjyken administrative (Kuopio County Administrative Court) duke kerkuar qe te degjoheshin nga gjykata ne nje seance degjimore ne menyre qe ata te mund te parashtronin faktet dhe sidomos premtimin e bere nga administrata. Ne 1998 Gjykata administrative rrezoi kerkesat e tyre duke deklaruar se nuk ishte e nevojshme per vendimmarrjen e saj paraqitja e ankuesve ne nje seance degjimore, pasi vetem Ministria e Finances mund te akordonte shtesa ne rroge. Gjithashtu gjykata konstatoi se ne asnje rast tjeter nenpunesve civile nuk u ishte autorizuar rritja e rroges ashtu sic e pretendonin ankuesit. Ankuesit paraqiten rekurs ne Gjyken e Larte Administrative duke pretenduar te degjohen nga gjykatat pasi ata mund te provonin se nenpunes te tjere kishin perfituar nga shtesa e rroges ne kushte te ngjashme me ta. Ne vitin 2000 rekursi i tyre u rrezua dhe gjykata konfirmoi mungesen e nevojës per te degjuar palet.

Ne keto kushte ankuesit paraqiten nje kerkese ne GJEDNJ kunder shtetit te Finlandes duke pretenduar se mohimi i te drejtes per tu degjuar nga gjykatat dhe kohezgjatje e paarsyeshme e procesit ne fjale shkelte garancite e parashikuara ne nenin 6 te Konventes. Ata pretenduan edhe shkelje te nenit 1 te Protokollit nr 1 si dhe nenet 14 dhe 13 te Konventes.

Me 29 nentor 2005 Seksioni i Katert i GJEDNJ vendosi pranueshmerine e ceshtjes dhe trajtimin e zbatueshmerise se garancive te nenit 6 se bashku me themelin e ceshtjes.

Me date 21 mars 2006, Dhoma vendosi te kaloje juridiksionin e saj ne favor te Dhomes se Madhe ne menyre qe te vendoste nje praktike te re unifikuese ne lidhje me zbatimin e garancive te nenit 6 te Konventes ne mosmarreshjet me pale nenpunesit publik, ne te cilat deri ne ate moment ishte zbatuar rregullimi i Gjykates ne ceshtjen Pellegrin k. Frances.

Komente mbi Vendimin e Dhomes se Madhe

Sipas Nenit 6 te Konventes, cdokush gezon te drejten per nje gjykim te drejte, posacerisht brenda nje kohe te arsyeshme, ne percaktimin e te drejtave te tij/saj civile. Qe Neni 6 te gjeje zbatim, duhet te egzistojte nje e "drejte" qe duhet te jete "civile" si natyre. Ne kete rast, Qeveria vuri ne dyshim zbatimin e Nenit 6 ne dy nivele, qe do te thote nese kishim te benim me nje te "drejte" dhe nese ajo kishte nje natyre "civile".

Ne lidhje me piken e pare, Gjykata arriti ne perfundimin se ankuesit mund te pretendonin se kishin patur te drejte qe mund te vertetohet dhe qe si pasoje nuk mund te perjashtohet zbatimi i Nenit 6.

Ne lidhje me piken e dyte, Qeveria kishte argumentuar se Neni 6 nuk ishte i zbatueshem meqenese sipas praktikese se Gjykates, mosmarreshjet qe perfshinin nenpunesit e shtetit si per shembull punonjesit e policise pertej kushteve te sherbimit ishin te perjashtuar nga ky Nen.

Gjykata kishte vendosur se te vetmet mosmarreshje qe perjashtoheshin nga qellimi i Nenit 6 § 1, ishin ato lidhur me nepunesit civile, detyrat e te cileve ilustrojne aktivitetet specifike te sherbimit publik, perderisa ky i fundit sherben si perfaqesues i autoritetit publik, pergjegjes per mbrojtjen e interesave te pergjithshme te Shtetit apo autoriteteve te tjere publike. Nje shembull i qarte i te tilla aktiviteteve u dha nga forcat e armatosura dhe policia.

Pas rishikimit te perdorimit te ketij kriteri funksional, Gjykata arriti ne perfundimin se ai nuk e kishte thjeshtuar analizen per zbatimin e Nenit 6 ne ato procese ne te cilat nepunesit civile mund te konsideroheshin pale, apo te rritjes se sigurise ne kete fushe. Gjykata, vleresoi se ceshtja Pellegrin k Frances duhej pare duke marre parasysh praktiken e meparshme, meqenese perben nje hap me tej nga parimi sipas te cilit Neni 6 nuk mund te zbatohet per nepunesit civile. Ai pasqyron kushtin paraprak sipas te cilit disa nepunes civile per shkak te funksioneve te tyre, ishin te kufizuar permes nje marreshje te posacme besimi dhe besnikerie ndaj punedhenesve te tyre.

Ishte e dukshme, nisur nga rastet e gjykuara me pas, se ne shume Shtete Pale aksesit ne gjykate i njihej nepunesve civile, duke i mundesuar atyre shqyrtimin e kerkesave ne lidhje me pagen dhe lejen, madje dhe ne lidhje me pushimin nga puna apo rekrutimin, sikunder te punesuarit ne sektorin privat. Sistemi vendas, ne te tilla kushte, nuk bente dallim ndermjet interesit themelor te Shtetit dhe te drejtes se individeve per mbrojtje.

Gjykata, si pasoje vendosi te adoptoje nje perqasje te re ne kete fushe, sipas te ciles, ne menyre qe shteti te mbeshtetet ne statusin si nepunes civil te kerkuesit, per te perjashtuar zbatimin e Nenit 6, duhet te permbushen dy kushte. Se pari, Qeveria ne legjislacionin e tij vendas duhet qe shprehimisht te kete perjashtuar aksesin ne gjykate, pozicionin apo kategorine e stafit ne fjale. Se dyti, perjashtimi duhet justifikuar mbi baza objektive ne interes te Shtetit.

Fakti i thjeshte qe ankuesi ishte ne nje sektor apo departament qe perfshin perdorimin e forces ne perputhje me ligjin publik, nuk eshte ne vetvete vendimtar.

Ne menyre qe te justifikohet perjashtimi, nuk ishte e mjaftueshme qe Qeveria te vertetonte se nepunesi civil ne fjale kishte marre pjese ne ushtrimin e pushtetit publike, apo perdorimit te fjaleve te Gjykates ne ceshtjen Pellegrin, «nje marreveshje e posacme besimi dhe besnikerie » mes nepunesit civil dhe Shtetit si punedhenes.

Qeveria gjithashtu duhet te tregonte qe ceshtja thelb e mosmarrveshjes ishte e lidhur me zbatimin e forces, apo qe vinte ne diskutim marreveshjen e posacme. Si rrjedhim, ne parim nuk do mund te kishte asnje justifikim per perjashtim nga garancia e Nenit 6 mbi mosmarrveshje te zakonshme pune, si p.sh ato lidhur me rrogat, lejet dhe me perfitime te tjera te ngjashme, mbi bazen e natyres se vecante te marredhenies mes nepunesit civil ankues dhe Shtetit ne fjale.

Atehere ne fakt, egzistonte mundesia qe Neni 6 mund te zbatohet. Duhet qe Qeveria e paditur te provonte, se pari, se nepunesi civil ankues nuk gezonte te drejten per akses ne gjykate, ne perputhje me legjislacionin vendas dhe, se dyti, se perjashtimi nga te drejtat e Nenit 6 per nepunesin civil ishte i justifikuar.

Ne ceshtjen ne shqyrtim nuk diskutohet nese ankuesit kishin patur te gjitha akses ne gjykate sipas ligjit vendas. Si pasoje, Neni 6 § 1 ishte i zbatueshem.

Pasi u mor me nje ceshtje te tille mbi zbatimin e Nenit 6, GJEDNJ, vazhdoi mbi shqyrtimin e qellimit dhe permbajtjes se nenit 6.

E drejta per gjykim te drejte:Se pari, Gjykata shqyrtoi rendesine e te drejtes te kohezgjatjes se procedimit vendas, duke theksuar se justifikimi do te vleresohet duke marre parasysh rrethanat e vecanta te rastit, ne menyre te vecante, kompleksitetin e rastit dhe sjelljen e ankuesit dhe autoriteteve te rendesishme. Ajo gjeti ne kete pike se rasti nuk ishte as kompleks, as i vecante. Ajo gjithashtu konstatoi se ne ceshtjet civile, koha e arsyeshme mund te nise, ne disa kushte, edhe para nxjerrjes se urdhrat gjyqesor per fillimin e procedimit nga gjykata ku paditesi paraqet padine.

Duke marre ne konsiderate kohezgjatjen e procedurave ne kete rast, GJEDNJ konkludoi se 4 vjet qe u perdoren nga Bordi Administrativ per te vleresuar rastin, nuk kishin asnje "justifikim te mjaftueshem". Nga ana tjeter, vonesa ne procedim te Bordit Administrativ ishin ne kundersizim me Konventen.

Gjykata vendosi dhenien e nje shume prej 2500 euro per secilin ankues si demshperblim per demin moral te shkaktuar nga kohezgjatja e procedimit.

Seanca e shqyrtimit/seanca degjimore :GJEDNJ vazhdoi me pas me vleresimin e mundesise per organizimin e nje seance degjimore si kusht per nje gjykim te drejte. GJEDNJ se pari u shpreh se parimet e rendesishme ishin pasqyruar ne gjykimin e saj te meparshem ne ceshtjen Jussila k. Filandes ([GC] No 73053/01, §§40-45). Ajo konstatoi se qellimin i ankuesve per te kerkuar nje seance degjimore ishte qe te siguronin deshmi se zyrtaret lokale kishin premtuar se humbjet e rrogave individuale do te kompensoheshin, nderkohe qe qeveria Filandeze kishte argumentuar se nje seance e tille ishte e panevojshme, meqenese informacionin i rendesishem mund paraqitet dhe ne forme te shkruar. Gjykata ra dakort me kerkesen e Qeverise Filandeze se ceshtjet e rendesishme mund te percaktoheshin bazuar vetem ne kerkesat me shkrim.

Ne rastin konkret duke pasur parasysh se ankuesve ju ishte dhene mundesia per te parashtruar rastin dhe per te dhene komente mbi palen tjetere, GJEDNJ vleresoi se e drejta per nje seance degjimore te drejte nuk ishte dhunuar pavaresisht se nje seance degjimore nuk ishte realizuar.

BOCELLARI dhe RIZZA k. Italisë

Titulli: *Kozacioğlu Tur*

Titulli: *Kozacioğlu Tur*

Ankesa Nr

Titulli: *Turcia Kozacioğlu Tur*

Titulli: *Kozacioğlu Tur*

Ankesa Nr

Shteti *Turqia*

Pergjegjes

Data e vendimit *19 shkurt*

Organi vendimmarres

Dhoma e madhe (Grand Chamber)

Thelbi i vendimit

Ankuesi pretendon shkelje te te drejtes se tij per te gezuar pronen. Gjithashtu ai pretendoi se procesi i zhvilluar nga gjykatat vendase ishte i parregullt pasi gjykatat nuk kishin caktuar nje ekspert te kualifikuar ne historine e artit ne menyre qe te vleresonte vleren kulturore dhe historike te godines objekt gjykimi. Gjykata vendosi se mungesa e marrjes parasysh te karakteristikave te nje prone te shpronesuar ne perlogaritjen e kompensimit te saj perben shkelje te te drejtes se prones te garantuar nga Konventa.

Nenent e KEDNJ: *Neni 6
Neni 1P1
Neni 41*

Konkluzioni *Analiza e nenit 6 ne kuadrin e nenit 1P1
Shkelje e nenit 1P1
Akordim demi material*

Link ne HUDOC

<http://cmiskp.echr.coe.int/tkp197/view.asp?action=html&documentId=847442&portal=hbkm&source=externalbydocnumber&table=F69A27FD8FB86142BF01C1166DEA398649>

Fjalekyce per kerkim ne HUDOC

*"DEPRIVATION OF PROPERTY" "EXHAUSTION OF DOMESTIC REMEDIES" "JUST SATISFACTION{ART 41}" "MARGIN OF APPRECIATION" "PECUNIARY DAMAGE" "PROPORTIONALITY" "PUBLIC INTEREST{P11}" "SIX MONTH PERIOD"
Beveler v. Italv [GC], no. 33202/96, §§ 106, 107 and 112, ECHR 2001 ; Beveler v.*

Faktet dhe pretendimet

Ankuesit jane shtetas Italiane. Ne 1997 prokuroria filloi procedim penal kunder Z Bocellari, nje avokat i specializuar ne te drejten penale, me akuzen per bashkepunim ne trafik droge dhe pastrim parash. Ne vitin 2002 gjykatat vendosen pafajesine e ankuesve. Ne kuadrin e dyshimeve te ngritura ndaj Z Bocellari, prokuroria e Milanos filloi procedura paralele ne mars 1999 per te siguruar zbatimin e masave te sigurise personale dhe pasurore te parashikuar nga Ligji Nr 575/1965 i ndryshuar. Ne perfundim te ketij procesi gjykatat italiane vendosen, nder te tjera, te vendosin Z Bocellari ne residence te detyrueshme ne qytetin e Milanos per 4 vjet si dhe konfiskuan disa prona ne pronesi te te dy ankuesve.

Ankuesit paraqiten kerkese ne GJEDNJ duke pretenduar shkelje te nenit 6 § 1 te KEDNJ (e drejta per nje proces te rregullt) pasi ne procesin per vendosjen e masave te sigurise personale dhe pasurore ndaj Z Bocellari nuk ishte zhvilluar ne seance publike.

Komente mbi Vendimin e Dhomes

Ne vendimin e saj Gjykata theksoi se karakteri publik i procesit gjyqesor mbron palet nga zhvillimi i procesit gjyqesor ne sekret dhe pa kontroll te te tretteve si dhe garanton besueshmerine e gjyqesorit perpara popullit.

Gjykata konstatoi ne menyre te vecante se eshte shume e rendesishme qe ne procedurat per sigururimin e masave te sigurise personale dhe pasurore ne kuadrin e nje procesi penal, paleve tu jepet nje mundesi per tu degjuar ne seance degjimore te mbajtur publikisht ne gjykatat e e shkalles se pare apo edhe ne apel. Duke pasur parasysh se ankuesve ne rastin konkret nuk u ishte dhene asnje mundesi per tu degjuar nga gjyqesori ne procesutrat per venien e masave te sigurise ne unanimitet ajo vendosi shkelje te nenit 6 § 1 te Konventes. Ne kuader te nenit 41 te Konventes Gjykata vendosi se ne kushtet e rastit konkret deklarimi i shkeljes konsistonte ne vetvehte nje demshperblim te drejte per demin material. Prandaj ankuesve iu akordua vetem nje kompensim per shpenzimet e kryera rreth 2000 Euro.

BEIAN k Rumanise (no 1)

Titulli: Kozacioğlu Tur

Titulli: Kozacioğlu Tur

Ankesa Nr

Titulli: Turci Kozacioğlu Tur

Titulli: Kozacioğlu Tur

Ankesa Nr

Shteti Turqia

Pergjegjes

Data e vendimit 19 shkurt

Organi vendimmarres

Thelbi i vendimit

Nenent e KEDNJ: Neni 6
Neni 1P1
Neni 41

Link ne HUDOC

Fjalëkrye per kerkim ne HUDOC

Dhoma e madhe (Grand Chamber)

Ankuesi pretendon shkelje te te drejtes se tij per te gezuar pronen. Gjithashtu ai pretendoi se procesi i zhvilluar nga gjykatat vendase ishte i parregullt pasi gjykatat nuk kishin caktuar nje ekspert te kualifikuar ne historine e artit ne menyre qe te vleresonte vleren kulturore dhe historike te godines objekt gjykimi. Gjykata vendosi se mungesa e marrjes parasysh te karakteristikeve te nje prone te shpronesuar ne perlogaritjen e kompensimit te saj perben shkelje te te drejtes se prones te garantuar nga Konventa.

Analiza e nenit 6 ne kuadrin e nenit

1P1

Shkelje e nenit 1P1

Akordim demi material

Konkluzioni

<http://cmiskp.echr.coe.int/tkp197/view.asp?action=html&documentId=847442&portal=hbkm&source=externalbydocnumber&table=F69A27FD8FB86142BF01C1166DEA398649>

"DEPRIVATION OF PROPERTY" "EXHAUSTION OF DOMESTIC REMEDIES" "JUST SATISFACTION{ART 41}" "MARGIN OF APPRECIATION" "PECUNIARY DAMAGE"

Faktet dhe pretendimet

Ankuesi eshte me shtetesi Rumene. Ai pretendoi se procedurat per njohjen e nje pensioni te vecante te njohur atyre te cilet kishin kryer pune te detyruar gjate sherbimit ushtarak nuk ishin zhvilluar ne respektim te garancive te nenit 6 te Konventes (Procesi i rregullt gjyqesor). Gjithashtu ai pretendoi se ai kishte pasur nje trajtim diskriminues ne krahasim me persona te tjere te ndodhur ne te njejten siuate.

Komente mbi Vendimin e Dhomes

Gjykata vendosi me unanimitet se procesi ne rastin konkret kishte qene i parregullt ne shkelje te nenit 6 § 1 (right to a fair trial) si dhe neni 14 i Konventes (prohibition of discrimination) ne lidhje me te drejten e prones se ankuesit garantuar nga neni 1 i Protokollit No. 1 (protection of property) si rezultat i praktikes kontradiktore te Gjykates se Larte. Gjykata i akordoi Z Beian 5,000 Euro ne titull demshperblimi.

Vendimet e Gjykates Evropiane te te Drejtave te Njeriut te cilat do te analizohen ne numrin qe vijon:

1. S. dhe Marper k. Mbreterise se Bashkuar, Vendim i Dhomes se Madhe date 4 dhjetorit 2008

Problematikat qe trajton: Ruajtja nga ana e autoriteteve e shenjave te gishtrinjeve, analizave te gjakut dhe AND te individeve edhe pasi ata jane deklaruar te pafajshem nga gjykatat.

2. Oneryildiz k Turqise, (nr 48939/99) vendim i Dhomes se Madhe date 30 nentor 2004

Problematikat qe trajton: Deshtimi I autoriteteve Turke te mbronin jeten dhe pronen e ankuesve pas nje shperthimi te ndodhur ne nje zone qe perdorej per grumbullimin e mbeturinave prane banesave te tyre

3. Enea k Italise (nr 74912/01) vendim i Dhomes se Madhe date 17 shtator 2009

Problematikat qe trajton: Kushtet e burgimit te nje personi te semure te mbajtur ne regjimin e burgimit te Sigurise se Larte

4. Scordino k. Italise (no. 1), (nr. 36813/97), vendim i Dhomes se Madhe date 29 mars 2006

Problematikat qe trajton: Efikasiteti i mjeteve juridike te ofruara nga Ligji Pinto (per trajtimin e pretendimeve per zvarritje te procesit)

5. Opuz k Turqise, (nr 33401/02), vendim i Seksionit te Trete te GJEDNJ date 9 qershor 2009.

Problematikat qe trajton: Deshtimi I autoriteteve Turke te mbronin ankuesen dhe nenen e saj nga dhuna ne ambjentet familjare